



Pranuar / Doretuar Përmirësi/Prodato Received/Delivered	17-08-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prllog Appendix	Sakla Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5703/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.908/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.908/2023, të datës 05.07.2023 të ankuesit me adresë rruga kundër Vendimit me Nr.862 të datës 27.06.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Rahovecit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.908/2023 e datës 05.07.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.862 i datës 27.06.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Rahovecit.
- III. Anulohet konkursi me Nr. Referencës: RN00011575 për emrin e grupit "Specialist i Arsimit" për pozitën Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë të shpallur më datë 02.05.2023 nga Komuna e Rahovecit, dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Rahovecit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Rahovecit, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën III të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Rahovecit më datë 02.05.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Referencë: RN00011575 për grupin Specialit i Arsimit, pozita *Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë*, me afat aplikimi nga data 23.05.2023 deri më datë 30.05.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është përfshirë në listën e shkurtër dhe i është nënshtruar testit me shkrim duke marr gjithsej 38 pikë.

Pas përfundimit të fazave të procedurës sipas renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 21.06.2023, rezulton se ankuesi nuk është kandidat fitues për shkak që nuk ka arritur të kaloj fazën e testit me shkrim.

Më datë 22.06.2023 ankuesi ka parashtruar ankesë tek Njësia e Personelit e Komunës së Rahovecit me pretendimet për shkelje procedurale gjatë këtij procesi. Komisioni i Pranimit më datë 27.06.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.862 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 22.06.2023.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.862 të datës 27.06.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Rahovecit, më datë 05.07.2023 ka parashtruar ankesë numër protokollit 5014/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 06.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese te Komuna e Rahovecit. Ndërsa Këshilli me datë 10.07.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.07.2023 me numër protokollit 5014/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Ankesa për Komisionin e pranimit i datës 22.06.2023, Kërkesë për Zyrën e Personelit e datës 16.06.2023; Ankesë e datës 09.06.2023; CV-ja e ankuesit; Lista e ngushte me numër 682 e datës 02.06.2023; Konkurs i datës 02.05.2023; Vendim i Komisionit të Rekrutimit me numër 862 i datës 27.06.2023; Vërtetim me numër Ref.nr.368/2023 i datës 26.05.2023;E-mail dërguar nga drejtuar i datës 27.06.2023; Kontratë punë për mësimdhënës i datës 01.09.2015; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me numër 189/112 i datës 20.04.2012; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me numër 1813 i datës 30.06.2011;Certifikatë mbi dënimet penale e datës 23.05.2023; Pasqyrë e llogarisë në Trust për periudhën 19.05.2022 deri 19.05.2023;Licencë e mësimdhënësit me numër 100008174 e datës 26.12.2012; Aktvendim mbi licencimin e mësimdhënësit me numër të protokollit 08/2012/8174; Certifikatë e lëshuar

nga Ministria e Arsimit shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit dhe Edumen Education-Dhjetor 2022; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Instituti i Pedagogjisë i Kosovës; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë me numër 133; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e datës 13.02.2005; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe KEC me numër 32302/078 e datës 31.05.2021; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Instituti i Pedagogjik i Kosovës-2014; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe KEC me nr.32556/076 e datës 31.05.2021; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe KEC e datës 08.12.2020; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK- Dhjetor 2019; Certifikatë e lëshuar nga USAID dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-mars 2013; Certifikatë e lëshuar nga Qendra për Arsim e Kosovës me numër 6625/027 e datës 15.03.2007; Certifikatë e lëshuar nga Qendra për Arsim e Kosovës me numër 6198/026 e datës 15.12.2006; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, dhe Teknologjisë dhe SBASHK me numër 1038/003; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për muajin maj 2006; Certifikatë e lëshuar nga Zyra për Qeverisje të mirë, IOM, UNMIK dhe Qeveria e Finlandës; Certifikatë e lëshuar nga Kosovo Education Development Project; Certifikatë e lëshuar nga Shtëpia e Sigurisë e datës 26.09.2019; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, dhe Teknologjisë dhe SBASHK e datës 29.11.2015; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-Shkurt 2020; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë e datës 05.07.2020; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, dhe Teknologjisë e datës 01.07.2016; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, dhe Teknologjisë e datës -2018; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës, dhe Teknologjisë e datës -2017; Certifikatë e lëshuar nga Learning Together; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit shkencës dhe teknologjisë e datës 29.09.2006; Modulet e Programit Udhëheqja Arsimore; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Arsimit shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit, GIZ dhe KCDE-Korrik 2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 06.07.2023; Përgjigja në ankesë e datës 10.07.2023; Lisat e kandidatit fitues me numër 829 e datës 22.06.2023; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 03.07.2023; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 15.07.2023; Pyetjet e testit me shkrim; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 21.06.2023; E-mail i dërguar nga drejtuar aplikantëve e datës 07.06.2023; E-mail i dërguar nga drejtuar aplikantëve e datës 09.06.2023; Lista e aplikantëve; Vendim mbi formimin e Komisionit me numër 689 i datës 05.06.2023; Certifikatë e lëshuar nga CDRSEE; Kopja e letërnjoftimit e Pasqyra e llogarisë në Trust për periudhën kohore 15.06.2017 deri 19.05.2023; Kopja e letërnjoftimit e ; Vërtetim i lëshuar nga Universiteti "Fehmi Agani" me nr.ref.03/94 i datës 24.05.2023; Vërtetim i lëshuar nga Universiteti "Fehmi Agani" me nr.ref.03/95 i datës 24.05.2023; Letër rekomandimi për e datës 27.06.2022; Certifikatë mbi dënimet penale për e datës 24.05.2023; CV-ja e ankuesit Diplomë e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina" me numër 105 i datës 08.10.2018; Vula Apostille me numër 58484/18 e datës 10.10.2018; Vërtetim i kopjes nga origjinali me numër LRP.Nr.rendor.5731/2020 i datës 14.10.2020; Diplomë e lëshuar nga SH.M."12 Maji" e datës 08.07.2014; Diplomë e lëshuar nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë me numër të diplomës 351 i datës 28.10.2020; Vërtetim i lëshuar nga Universiteti "Ismail Qemali" me nr.371/2 i datës

05.07.2021; Vërtetim i njësish nga origjinali datës 05.07.2021; Vërtetim i kopjes nga origjinali me numër LRP.Nr.rendor.12260/2021 i datës 12.10.2021; Vendim me nr.ref.216-4831 i datës 27.10.2021; Marrëveshje për shërbime të veçanta me nr.prot.03/1453 i datës 21.11.2018; Vërtetim i lëshuar nga Universiteti "Fehmi Agani" me nr.ref.03/791 e datës 06.05.2022; Marrëveshje për shërbime të veçanta e lëshuar nga Universiteti i Gjakovës me numër prot.01/267 i datës 04.04.2018; Marrëveshje për shërbime të veçanta me nr.04-052-3168 i datës 09.09.2019; Marrëveshje për shërbime të veçanta me nr.prot.01/1002 i datës 25.10.2017; Certifikatë e lëshuar nga Internacional Conferenc on Law and Art dhe Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë; certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike –Maj 2021; Certifikatë e lëshuar nga Center for Education and Training me numër 02/17; Certifikatë e lëshuar nga Brigada për reagim të shpejt e datës 02.07.2018 Istog; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti "Fehmi Agani"; Certifikatë e lëshuar nga Instituti Forca Rinia; Certifikatë e lëshuar nga KDI dhe KFOS e datës 19.04.2018; Certifikatë e lëshuar nga Komuniteti shqiptar i Helsinkit dhe Ambasada Amerikane -dhjetor 2018; Certificate e lëshuar nga Shërbimi Kombëtar për Rini i datës 21.05.2020; Certifikatë e lëshuar nga Kuvendi i të rinjve të Kosovës i datës 27.12.2019; Certifikatë pjesëmarrje e lëshuar nga Kuvendi i të rinjve të Kosovës dhjetor 2019; Certifikatë e lëshuar nga ICK dhe Zyra Kosovare për bashkëpunim me Zvicrën; Certifikatë e datës 04.05.2017; Certifikatë e lëshuar nga London School of English e datës 04.06.2008; Certifikatë e lëshuar nga London School of English e datës 30.06.2009; Certifikatë e lëshuar nga Polar Bear; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit, Salto-Youth dhe Erasmus+; Certifikatë e lëshuar nga OSCE e datës 05.10.2018; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" e datës 31.05.2020; e datës 31.05.2020; Certifikatë e lëshuar nga KCSF, Sbuker e datës 13.04.2018; Certifikatë e lëshuar nga SHKR dhe Qendra Rajonale Rinore në Vlorë e datës 19.06.2019; Certifikatë e lëshuar nga ETS-TOEIC e datës 05.06.2020; Certifikatë e lëshuar nga Konferenca internacionale drejt zhvillimit të qëndrueshëm e datës 28.10.2017; Letër mirënjohje e lëshuar nga Unioni i Studentëve Shqiptarë i datës 30.12.2022; Vërtetim mbi pjesëmarrjen ne Youth Exchanges e datës 18.02.2018; Vërtetim mbi pjesëmarrjen ne Youth Exchanges e datës 17.02.2018; Certifikatë e lëshuar nga Opportunity center e datës 28.11.2022; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Kulturës rinis dhe Sportit dhe KISED e datës korrik n2019; Certifikatë e lëshuar për vullnetarin e vitit e datës 27.12.2019; Certifikatë e pjesëmarrjes e lëshuar nga Qendra UET dhe Projekti i Unionit Evropian ; Mirënjohje e lëshuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës e datës 12.01.2022; Certifikatë e lëshuar nga YMCA i datës nëntor 2022; Kërkesë për prova shtesë e datës 17.07.2023; Përgjigjen e datës 24.07.2023; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit 01Nr.1200 të datës 11.04.2019; Akt Emërimit 01Nr.4629 i datës 30.10.2012; Akt Emërimit 01Nr.4640 i datës 12.12.2014; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit 01Nr.3290/6 i datës 18.08.2013; Kontratën e punës me Nr. 308 të datës 16.01.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 182 të datës 2.06.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Rahovecit, pretendon se ka pasur shkelje të dispozitave të Ligjit

Nr.06/L-114 për Zyrтарët Publikë dhe Rregullores (QRK) nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ngase për këtë pozitë kërkohet që kandidatët të kenë përvojë punë në mësimdhënie ndërsa kandidati fitues nuk e ka përvojën e punës në mësimdhënie.

Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin për grupin "*Specialist i Arsimit -Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë*" me Nr.Referencës: RN00011575 të shpallur më datë 02.05.2023, kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve Universitare me të paktën 180 kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to drejtimi edukim.*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvoje pune.*

Sa i përket mënyrës së shpalljes së konkursit konkretisht kërkesave të përgjithshme formale, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrтарët Publikë është bërë kategorizimi i pozitave në shërbimin civil siç parashihet me nenin 33 paragrafi 2, i cili përcakton se: "2. Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. *Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme*; 2.2. *Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të*; 2.3. *Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të*; dhe 2.4. *Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë*", atëherë Kolegji i Këshillit, në vështrim të nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me pozitat e kategorisë profesionale është përcaktuar se: "1. *Klasat përbërëse të kategorisë profesionale dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1 Profesional 2 Profesional 3*", rrjedhimisht meqenëse pozita e shpallur nga Komuna e Rahovecit është e kategorisë profesionale klasa profesionale 2, atëherë sipas shtojcës Nr. 1/7 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën Profesional 2, konkretisht kërkesat e përgjithshme formale janë përcaktuar: a) *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK)*", c) *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*, si rrjedhojë Komuna e Rahovecit me rastin e shpalljes së këtij konkursi ka tejkalluar përcaktimin ligjor më konkretisht tek përvoja e punës ka kërkuar *Së paku dy (2) vite përvoje pune*, si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit, thekson faktin se përvoja e punës për pozitën përkatëse duhet të jetë së paku një (1) vit dhe e njëjta duhet të jetë në fushën për të cilën zhvillohet kjo procedurë, ndërsa Komuna e Rahovecit me kriteret e vendosura në konkursin e shpallur, i është mohuar e drejta e aplikimit të kandidatëve të tjerë që kanë pasur përvojën e punës një vjeçare, ngase ka vendosur kriteret më të larta se ajo që është paraparë në rregulloren përkatëse.

Po ashtu ndërlidhur me Shtojcën Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, renditja numër 49 e Grupit- *Specialistë i Arsimit*, respektivisht tek fusha e kërkuar e arsimit është përcaktuar: "*Mësimdhënie apo një degë e caktuar e shkencës përkatëse dhe*

eksperiencë në mësimdhënie“, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Komuna e Rahovecit me rastin e shpalljes së konkursit të datës 02.05.2023, me Nr. Reference: RN00011575, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material lidhur me përcaktimin e kriterëve të kualifikimeve profesionale, pasi që për grupin e pozitive “*Specialistë i Arsimit*“ kërkohet që fusha e arsimit të kandidatëve të jetë Mësimdhënie apo një degë e caktuar e shkencës përkatëse dhe eksperiencë në mësimdhënie, ndërsa në konkursin e lartcekur ky kriter nuk ka qenë i përcaktuar, ngase i përcaktuar ka qenë vetëm *drejtimi edukim*, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, thekson se në rastet e pozitive të këtij grupi, institucioni duhet të përcaktoj kualifikime arsimore që kanë ndërlidhje me fushën e mësimdhënies, ndërsa në rastin konkret kjo çështje është kufizuar vetëm në një fushë e që nga kandidatët mund të nënkuptohet vetëm për ato drejtime që janë të përfunduara në drejtimin e edukimit.

Duke marr parasysh që kërkesat e përgjithshme formale sipas këtij konkursit kanë qenë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe duke pasur parasysh faktin e shmangies së këtyre kërkesave nga Komuna e Rahovecit, Kolegji i Këshillit, konstaton se nga dosja e kandidatit fitues rrjedhë se i njëjti posedon Diplomën me Nr.105 të lëshuar nga Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani“, me të cilën dëshmohet se më datë 28.09.2018 ka përfunduar studimet themelore në Programin Gjuhë Shqipe në Fakultetin e Filologjisë duke marr titullin Baçelor i Gjuhës Shqipe, lidhur me përvojën e punës i njëjti nuk posedon përvojë punë dhe eksperiencë në mësimdhënie.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas Vendimit A.nr.361/2023 të datës 28.03.2023 ka anuluar konkursin me Nr. Reference: RN00010547 për grupin Specialist i Metodave të Arsimit (Metolog Arsimi), për shkak të përcaktimit të kërkesave të përgjithshme formale në kundërshtim me Rregullore (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, atëherë në momentin kur është shpallur konkursi me Nr.Reference: RN00011575, është në fuqi Rregullorja (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se konkursi është dashur të shpallet në pajtim me këtë rregullore, mbi këtë bazë konstatohet se Komuna e Rahovecit nuk ka arritur të zbatoj dispozitat ligjore në fuqi.

Nisur nga konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Komuna e Rahovecit me rastin e shpalljes së konkursit për grupin “*Specialist i Arsimit -Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë*“ me Nr.Reference: RN00011575 të shpallur më datë 02.05.2023, ka vepruar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “1. *Pranimi në detyrë i nëpunësit Civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive*“, ngase në këtë konkurs kishte përcaktuar kriteret e përgjithshme formale sa i përket arsimimit dhe përvojës së punës në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, andaj mbi këtë

bazë me gjithë këto shkelje ky konkurs anulohet si në dispozitiv të këtij vendimit ndërsa, Kryetari i Komunës së Rahovecit është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi si në dispozitiv të tij.

Nga se u tha më lartë, Kolegji i Këshillit meqenëse ka konstatuar se me rastin e hapjes së konkursit të kontestuar me këtë ankesë nuk janë përfillur parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, ka vendosur se kjo përbën bazë të mjaftueshme ligjore që konkursi të anulohet në tersi, ndërsa nuk është lëshuar në shqyrtim e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit për asnjë fazë tjetër të rekrutimit apo veprim procedural që ndërliidhen me çështjen e pyetjeve të testit, pasi që nuk do të kishte asnjë efekt përmbajtësor, andaj si në dispozitiv të këtij vendimi Kryetari i Komunës së Rahovecit dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Rahovecit janë të obliguar të ndërmarrin veprimet e nevojshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.908/2023, datë 17/08/2023

Avdyl Bekteshi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.